

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:07

RENDI I DITËS

Për miratimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor “Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria
Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Mirmëngjesi të gjithëve. Atëhere në seancën e sotme publike, kemi në renditje këto çështje:

1. Projektvendim “Për miratimin,pra për shqyrtimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”.
2. Projektvendim “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Vlorë, të depozituar nga partia “Lëvizja e Legalitetit”.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

3. Projektvendim “Për kthimin për korrigjim të dokumentacionit të kandidimit, të listës shumemërore më saktë, të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të depozituar nga Partia “Fronti i Majtë”.
4. Është “Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e listave shumemërore të partisë politike “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”.
5. Kemi “Shqyrtimi i kërkesës për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë.
6. Projektvendim “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”.
7. Projektvendim “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave për këto zgjedhje”.
8. Projektvendim “Për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit”.
9. Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemeve Zgjedhore, për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 14 maj”.
10. Po kështu kemi “Shqyrtimin e kërkesës së Radio Televizionit Ora Neës, për të akredituar vëzhgues për këto zgjedhje”.
11. Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr. 79, datë 1.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë të organizatës Qëndresa Qytetare”. Dhe në fund kemi
12. Vlerësimin e raportimeve për veprimtaritë publike të institucioneve, për periudhën 10 mars – 16 mars 2023 dhe për periudhën 17 mars – 23 mars 2023”. Mirë dakord, atëhere fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e listave shumëemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Bashkiak të Partisë “Drejtësi Integrim dhe Unitet”. Për Tiranën akoma nuk kemi përfunduar. Po vazhdojmë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Me vendim nr. 117, datë 8.03.2023, të Komisionerit Qendror të zgjedhjeve, Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në mbështetje të ligjit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore, për kandidat për anëtarë të këshillit bashkiak. Në mbështetje të nenit 78 të Kodit Zgjedhor, administrate e KQZ-së, ka verifikuar listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkitë Durrës, Berat, Elbasan, Fier, Lushnjë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Kamëz dhe Vlorë, ku është konstatuar se janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. Në përputhje me nenin 5, pika 4, të ligjit nr. 138 të vitit 2015, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për bashkitë e mësipërme, kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjet, dhe emërim të funksionarit publik. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, rezulton se nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime me ligjin nr. 138 të vitit 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave të kandidatëve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka sjellë të dhënat e kandidatëve, ku konstatohet se kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tyre, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Për sa më sipër konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkitë Durrës, Berat, Elbasan, Fier, Lushnjë, Korçë, Lezhë, Shkodër, Kamëz, Vlorë, janë në përputhje me nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, dhe si të tilla duhet të pranohen. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, atëhere do të miratojmë listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, paraqitur nga Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, për Bashkinë e Durrësit, Bashkinë e Beratit, Bashkinë e Elbasanit, Bashkinë e Fierit, Bashkinë Lushnje, bashkinë Korçë, Bashkinë Lezhë, Bashkinë Shkodër, Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Vlorë.

Vendimi nr. 217

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:13

RENDI I DITËS

Për kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Vlorë, të depozituar nga Partia “Lëvizja e Legalitetit”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Mirë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia “Lëvizja e Legalitetit”, me vendimin nr. 134, datë 8.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në mbështetje të nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur listat shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, të Bashkisë Vlorë. Në bazë të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkisë, të Partisë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

“Lëvizja e Legalitetit”, ku në përfundim të procesit të verifikimit, u konstatuan mangësi dhe mospërputhje të dokumentacionit, si më poshtë: - Konstatohet se disa prej emrave të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të Bashkisë Vlorë, të c, figurojnë në listat shumemërore të një partie tjetër. Gjithashtu ID e depozituara nuk janë të sakta. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit kthimin për korigjim të listës shumemërore të kandidatëve anëtarë të këshillit të Bashkisë Vlorë, të Partia “Lëvizja e Legalitetit”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord. Atëhere do të vendosim për t’i kthyer për korigjim dokumentacionin, dhe afati është ora 24.00 e ditës së nesërme. Brenda këtij afati do të duhet të bëjnë plotësimet që ju kemi kërkuar, do tju kërkojmë.

Vendimi nr. 218

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:15

RENDI I DITËS

Për kthimin për korigjim të dokumentacionit të listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, të depozituar nga Partia “Fronti i Majtë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Po, kalojmë te pika tretë.

Z. Y. Merkaj: Partia “Fronti i Majtë” është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, në mbështetje të nenit 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të bashkisë. Bazuar në nenin 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimet e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Bashkisë Tiranë të Partisë “Fronti i Majtë”, ku në përfundim të procesit të verifikimit është konstatuar mangësi dhe mospërbushje të dokumentacionit si më sipër:

- Konstatohet se kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të bashkisë, Bashkia Tiranë, nuk respekton kuotën gjinore sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, gjithashtu konstatohet se lista shumemërore e kandidatëve për anëtarë të këshillit të bashkisë, për zonën e kandidimit Bashkia Tiranë, mbyllet me numrin rendor 32. Kjo listë nuk është në përputhje me pikën 4, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kandidatëve në listën shumemërore të përcaktuar sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjithashtu konstatohet se disa nga emrat e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit të bashkisë figurojnë dhe në lista shumemërore të një partie tjetër. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kthimin për korigjim të listës shumemërore për kandidatë të anëtarëve të këshillit të bashkisë, Bashkia Tiranë, të Partisë“Fronti i Majtë”. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Edhe për këtë subjekt do të caktojmë një afat, deri ditën e nesërme ora 24.00, për të bërë plotësimet e kërkuara nga ana jonë.

Vendimi nr. 219

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:17

RENDI I DITËS

*Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëpartisë politike “
Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, për zgjedhjet për organet e
geverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria
e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Atëhere vazhdojmë me pikën e katërt. Pika 4 është në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së Partisë “Aleanca e Maqedonas për Integrim Europian”. Këtë nuk do ta shqyrtojmë sepse është në kompetencë të KAS-it, shqyrtimi i këtij ankimi. Ata ankohen kundër vendimit të KZAZ-së, që nuk u ka pranuar dokumentacionin.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:17

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S'ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë! Kalojmë te pika tjetër, shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e zotit Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet e datës 14 maj.

Z. Y. Merkaj: Me vendim nr. 145, datë 8.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar i cili do të organizojë punën për paraqitjen e zotit Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Në datë 24.03.2023, Komiteti Nismëtar ka paraqitur në

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nënshkrimet e mbështetësve me 109 zgjedhës. Bashkelidhur është depozituar dhe dokumentacioni përkatës si mëposhtë:

- Deklarata e kandidatit për hapje logarie të posaçme,
- Jetëshkrimi i kandidatit,
- Lista e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështetin kandidatin, të nënshkruar prej tyre sipas modelit KQZ-04-01,
- Formulary i vetëdeklarimit
- Si dhe procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Neni 70, pika 3 përcakton se Komiteti mund të regjistrojë kandidat për kryetar bashkie, vetëm në rast se ka marrë mbështetjen e kandidatëve nga një numër zgjedhësish, që i korespondon shumës prej 1% të listës shumëmemërore, të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, dhe në çdo rast jo më pak se 50 zgjedhës. Referuar ekstraktit të fundit të listës së zgjedhësve, rezulton se zona zgjedhore Bashkia Tiranë ka 699 748 zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 70, të Kodit Zgjedhor, numri i zgjedhësve që i korespondon kufirit minimal prej 1 % të listës është 7 000 zgjedhësish. Nga verifikimi konstatohet se numri i paraqitur është shumë më pak se numri që duhet të paraqiste. Në këto kushte i kërkojmë Komisionerit mosregjistrimin e zotit Eduart Muhamet Nallbani, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëhere për arsyet që ju relatuat, vendos mosregjistrimin e zotit Eduart Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Dhe

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi brenda 3 ditëve, nga dita e shpalljes së tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 220

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:20

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Rregullator me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 ka caktuar rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë në Komisionet e Qendrave të Votimit. Gjithashtu me vendimin nr. 5, datë 19.02.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020”, ka përcaktuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prodhon vula rezervë me tekst unik për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023

zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

a) Numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi.

b) Formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë.

Mbështetur në analizën historike të të dhënave lidhur me numrin e kufizuar të rasteve që ky material zgjedhor është përdorur në zgjedhjet pararendëse si dhe bazuar në analizën e riskut, vlerësohet që sasia e vulave rezervë të KQV-ve në të cilat do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore do të jetë në masën e përafërt prej 10% të QV-ve të cdo KZAZ-je, në sasinë prej 520 vula. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, e miratojmë projektvendimin sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 221

Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 94, të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, sipas përcaktimeve në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu referuar nenit 4, pika1, të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, cakton me vendim Vendin e Numerimit të Votave të çdo ZAZ-je. Prefektët e Qarqeve kanë paraqitur në KQZ listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut përkatës. Për çdo objekt është referuar mjedisi ku mund të caktohet VNV-ja dhe është paraqitur planimetria e

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

objektit. Nga shqyrtimi i të dhënave të objekteve të paraqitura nga prefektët, rezulton se objektet dhe mjediset përkatëse përbushin kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, konkretisht si më poshtë:

- Janë salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive.
- Plotësojnë kriterin teknik të sipërfaqes bazuar në numrin e QV-ve të ZAZ-së.
- Përgjithësisht, janë brenda territorit të ZAZ-ve.
- Ofrojnë lehtësi logjistike të transportit rrugor nga QV-të e ZAZ-së.
- Ofrojnë kushte për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.
- Kanë sistem të pandërprerë të furnizimit me energji elektrike.

Prefekti i qarkut Dibër në propozimin e tij ka paraqitur për Bashkinë Klos dy ambiente për VNV. Ambienti i parë është ambjent privat i cili ka shërbyer si VNV edhe në zgjedhjet e vitit 2021. Propozimi tjetër është palestra e shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”, Klos. Administrata e KQZ pasi ka bërë verifikim në terren propozon që VNV të përcaktohet ambjenti shtetëror që është palestra e shkollës 9-vjeçare “Tahir Hoxha”. Bashkëlidhur keni dokumentacionin përkatës, me listën e objekteve të VNV-së dhe projektvendimin, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Tani këtë pikë të rendit të ditës, pra që ka të bëjë me caktimin e VNV-ve dhe pika tjetër, pika 8 do e shtyjme për nesër vendimmarrjen.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:24

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z .I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës të cilën e relatojmë, por për të vendosur do të vendosim nesër, meqenëse ka një kërkesë nga një subjekt zgjedhor për më shumë kohë për të vlerësuar projektvendimet.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 93, paragrafët 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, i propozon KQZ-së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizik ose juridik, duke paraqitur dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023

fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitë që ofron objekti për zhvillimin normal të zgjedhjeve, si dhe të dhëna të tjera për efekt të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor. Në rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ, KQZ-së i paraqitet propozimi dhe të dhënat e kërkuara vetëm për një objekt. Në KQZ janë administruar propozimet nga 34 (tridhjetë e katër) kryetarë të bashkive për caktimin e vendndodhjeve të 263 qendrave të votimit në ndërtesa private, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Për rastet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës së votimit nga zgjedhjet e kaluara afërsisht janë 15 qendra votimi dhe referohet arsyeja e ndryshimit, ku më së shumti është mospranimi i pronarëve të ambjenteve ta përdorin ambjentin e tyre për qendër votimi. Nga shqyrtimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, rezulton se propozimet përmbushin kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.1, të vitit 2020, të Komisionit Rregullator. Bashkëlidhur këtij relacioni është dhe lidhja me të dhënat për çdo qendër votimi, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Dakord! Sikurse thamë do të vendosim nesër edhe për këtë pikë të rendit të ditës.

Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:25

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:
 - Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
 - Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për akreditimin e vëzhguesve.

Z. Y. Merkaj: Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 30 (tridhjetë) vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve respekton kriteret e përcaktuara në nenin 6, të Kodit Zgjedhor dhe si e tillë duhet të pranohet. Për këto arsye i propozojmë Komisionerit Shtetëror të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

zgjedhjeve akreditimin e 30 (tridhjetë) vëzhguesve të Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratohet kërkesa e Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve për akreditimin e 30 (tridhjetë) vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 14 maj 2023.

Vendimi nr. 222

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:26

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Radio Televizionit Ora News, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me kërkesën e Radio Televizionit Ora News, për akreditim vëzhguesish.

Z. Y. Merkaj: Radio Televizioni Ora News, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin e përcaktuar në nenin 6, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Radio Televizioni Ora News është subjekt i cili gëzon të drejtën për të caktuar vëzhgues në zgjedhje përcaktuar në nenin 6, pika 2 e këtij kodi. Për këtë arsye i propozojmë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve akreditimin si përfaqësues të medias të 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) gazetarëve të Radio Televizionit Ora News, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, miratojmë dhe kërkesën e Televizionit Ora News për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet e 14 majit 2023.

Vendimi nr. 223

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023

akreditimin si vrojtues afatgjatë dhe të 5 (pesë) vëzhguesve të organizatës “Qëndresa Qytetare”.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratohet dhe kërkesa e organizatës “Qëndresës Qytetare” për akreditimin e 5 (pesë) vëzhguesve shtesë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Vendimi nr. 224

Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:28

RENDI I DITËS

Projektvendim “Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 10 mars – 16 mars 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me raportimet e institucioneve publike për periudhën 10 mars - 16 mars 2023.

Znj. A. Agolli: Atëherë për periudhën 10 mars – 16 mars 2023 janë raportuar në total 254 veprimtari nga 58 institucione. Nga këto 32 veprimtari të kryera nga 13 institucione janë në shkelje të afatit të raportimit. Mosaraportimi ka qenë për shkaqe si, problem me aksesimin e ndërfaqes, disa prej institucioneve kanë qenë në cilësinë e të ftuarit, kanë qenë veprimtari me karakter administrativ që lidhen me veprimtaritë funksionale dhe nuk kanë patur detyrimin për raportim, si dhe veprimtari për të cilat nuk krijohet bindja për karakterin publik. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, propozojmë moskonstatimin e shkeljes administrative si dhe pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon: Institucioni i

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

Presidentit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve, Prefekti i Qarkut Dibër, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, bashkitë, Korçë, Bulqizë, Kuçovë, Mat dhe Pukë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Me përjashtim të pjesës që lidhet me veprimtarinë e Presidentit të Republikës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të cilët do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ, për institucionet e tjera do të vendosim nesër ose ndoshta ditën e mërkurë.

Vendimi nr. 225

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

30.03.2023
Ora 11:30

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të
disa institucioneve, për periudhën 17 mars – 23 mars 2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y.Merkaj, Z. E. Meta**
Znj. A. Agolli, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **Të tjerë** **KRIIK, Përfaqësues nga Ministria
e Turizmit dhe Mjedisit.**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër që ka të bëjë po me këtë çështje por për periudhën 17 mars – 23 mars.

Znj. A. Agolli: Për periudhën 17 mars – 23 mars janë raportuar në ndërfaqen e raportimeve 310 aktivitete nga 64 institucione. Nga këto 37 raportime nga 15 institucione janë raportuar jashtë afatit të parashikuar. Deri tani kanë paraqitur pretendimet e tyre 9 institucione dhe jemi në shqyrtim të pretendimeve të palëve. Në seancën e rradhës besoj se mund të dalim me një vendimmarrje. Ndërkohë sjellim në vëmendje që KQZ po monitoron në baza ditore veprimtaritë e raportuara me vonesë si dhe veprimtaritë me pjesëmarrjen e personave partiakë. Nga këto

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.03.2023*

veprimtari janë ndaluar në total 17 prej tyre, nga të cilat 10 janë ndaluar për shkak të pjesëmarrjes së personave partiakë dhe 7 veprimtari për mosrespektim të afatit të raportimit.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë edhe për këtë raportim do të disponojmë me vendim ndoshta ditën e mërkurë të javës tjetër, duke patur kohë këto institucione deri ditën e mërkurë, për të sjellë nëse do e vlerësojnë, pretendime shtesë. Faleminderit, seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

